


TRIBUNA SINDIKALE

Maj 2006

Dhe drit' e diturisë
përpara do na shpjerë



Editorial

Objektiviteti i kërkesave të FSASH-it

Fillimet e marsit dhe vecanerisht muaji prill përbejnë periudhën e një negociimi intensiv midis Sindikatave të Arsimit dhe Ministrisë së Arsimit e Shkencës, lidhur me problemin e rritjes së pagave në sistemin parauniversitar për vitin 2006. Për shkak të mungesës së dialogut gjatë muajve janar-shkurt, sindikatat, në muajin mars u ndoën para faktit të kryer. Grupet e specialistëve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, të Departamentit të Administratës Publike dhe të Ministrisë së Financave etj, në mënyrë të njëanshme, pa asnjë konsultim me partneret sociale, paraqiten në Qeveri një projekt për rritjen e pagave për sistemin e arsimit parauniversitar për vitin 2006. Këtu nuk është fjala për një veprim formal, sa për të marrë një mendim, në vrapim e sipër, nga sindikatat, sa për të thënë që "i pyetën ato", por flitet për një obligim ligjor, për një konsultim institucional, për përpjekje të përbashkëta, me qëllim që të gjendeshin zgjidhjet me të pranueshme për të dy palët dhe, mbi të gjitha, zgjidhjet të beheshin mbështetur në kuadrin ligjor ekzistues të marrëdhënieve të punës.

Tanime është e njohur, që kjo mungesë e dialogu dhe tentativa për zgjidhje të njëanshme pa përfillur sindikatat, çoi në mospajtime për çështje esenciale. Cilat ishin në mënyrë të përbashkëta këto mospajtime?

Së pari, thuhet se rritja e pagave për vitin 2006 do të jete 27.4 përqind, sepse përfshihet në këtë rritje haqja e pages së 13-të dhe bëhet bashkimi i saj me pagën mujore.

Kundershtimi i FSASH këtu ishte i prerë dhe i vendosur, sepse paga e 13-të ishte fituar me levizje sindikale, me Marrëveshje kontraktuale dhe me vendimet përkatëse të Qeverisë dhe, mbi të gjitha, ajo nuk mund të konsiderohej rritje e pages, sepse këto pages mesuesit e sistemit parauniversitar e marrin që prej 8 vjetësh. Pra edhe nëse do të pranohet nga FSASH, (pasi ajo të konsultohet me strukturat e saj), shpërndarja e kesaj page në çdo muaj, duhet që kjo shpërndarje të bëhet mbasi paga e 13-të neto të rritej, sic rritej paga mujore, pra me mesatarisht 20 përqind.

Shkurt, ajo që kërkonte FSASH ishte që të zbatohet Marrëveshja e arritur me Kryeministrin në muajin nëntor 2005, që rritja e pagave për vitin 2006 të bëhet mesatarisht 20 përqind dhe të mos shpërndahet me shifra të tjera, sic ishin ato me 27.4 apo 28 përqind, etj.

Së dyti, shpërndarimi me një page mujore neto duhet t'u paguhet mesuesve edhe për 3 muaj e gjysëm, nga 1 janari deri në datën 15 prill, kështu që të cilën kjo page apo shpërndarimi

në formë page i bashkohet pages së zakonshme mujore.

Së treti, FSASH nuk ishte dhe nuk është dakort që të ketë diferencime në page sipas lendeve, për mesues që kanë arsim të njëjtit, vjetësi të njëjtit dhe kualifikim të njëjtit.

Së katërti, shpërndarimi i pritur prej 10 000 leke për mesuesit dhe gjithë punonjësit e arsimit në fund të çdo viti, të përfshihet në Vendimin e KM për rritjen e pagave.

Mbas disa dialogjimeve me MASH, kur nuk u arrit pothuajse asnjë zgjidhje, FSASH, kërkesat që cituan me sipër, ia bëri për të dytën herë të njohura Kryeministrit dhe Ministrit të Arsimit e Shkencës dhe njëkohësisht paralajmëroi fillimin dhe përkrahimin e levizjes sindikale, duke filluar me greven një orëshe më 21 prill, nëse këto kërkesa nuk do të merreshin parasysh.

Duke iu referuar kësaj kërkesave, në mbledhjen e Këshillit të Ministrave të datës 19 prill, Kryeministri Berisha saktësoi se rritja e pagave në arsimin parauniversitar për vitin 2006 do të jete 20 përqind, duke u dhënë fund spekulimeve për rritje të tjera fiktive. Po në këtë mbledhje, Kryetari i Qeverisë, duke folur për vendimin e rritjes së pagave, theksoi se përveç rritjes së pagave prej 20 përqind, punonjësit e sistemit të arsimit parauniversitar do të përfitojnë në fund të çdo viti, si gjithë punonjësit e tjerë në shpërndarim në masën 10.000 leke.

Në këtë mënyrë gjeten zgjidhje dy nga kater kërkesat kryesore që kishte paraqitur FSASH.

Duke qenë se, po në këtë mbledhje të Qeverisë, Kryeministri theksoi se Ministri Pollo duhet të negociojë me Sindikatën e Arsimit, sepse në kërkesat e saj të dyta ka vend për kompromis dhe konsensus, gjë që pajtohet me qëndrimin e pandryshuar të FSASH, që kërkesat e saj të zgjidheshin kryesisht me rregullin e bisedimeve, Këshilli Drejtues i Federatës ndërpreu veprimet sindikale dhe shprehu edhe një herë gatishmërinë për dialog për dy çështjet që kanë mbetur pa u zgjidhur dhe që konkretisht janë: Pagesa për mesuesit e sistemit parauniversitar për 3 muaj e gjysëm të efektive të pages 13-të neto, që është e përfshirë në buxhetin e këtij viti dhe mos diferencimi i pagave të mesuesve sipas lendeve.

Në pritje të zhvillimit të këtij dialogu, FSASH thekson se kërkesat e saj kanë qenë dhe mbeten objektive e të drejta, të bazuara ligjërisht dhe se ajo është e vendosur t'i mbrojë ato, në emër të anetareve që përfaqëson.

PERMBAJTJA

✓ Editorial: Objektiviteti i kërkesave të FSASH	2
✓ Mendimi i SPASH-it për rritjen e pagave për vitin 2006	3
✓ Arsimimi çështësor për të gjithë, një prioritet në Shqipëri	4
✓ Aktivitete në kuadrin e Javes së Veprimeve Globale për Arsimin në Shqipëri	6
✓ U festua 15 - Vjetori i FSASH-it	8
✓ Nga seminari zonal në Korçë	9
Per një përfshirje me të organizuar të sindikatave të arsimit në zbatimin e procesit të Bolonjes	10
✓ Me shumë përgjegjësi e perkushtim për plotësimin e kërkesave të anetareve	11
✓ Sindikatat kanë nevojë për drejtues të zotë	12
✓ Të hapet dialogu, të lidhen kontratat kolektive	12
✓ Bashkëbisedim me sindikalistet	13
✓ Në Shkollën e Mesme "Hoxhe Zogu" në Bytyç, Tropojë	14
✓ Të reja shkencore dhe keshilla praktike	15

Kopertina e pare:

Nga seminari me sindikaliste e pedagoge të arsimit të lartë

Kopertina e fundit:

Nga manifestimet në Diten e 1 Majit

TRIBUNA SINDIKALE

Nr. 21, Periodike

*Botim i FSASH dhe SPASH
ADRESA: Bulevardi "Zogu i Pare"*

Pallati Ali Kelmendi, kati III,

Tel: 22 83 46

Tel & Fax: 25 65 32

E-mail: fsash@icc-al.org

Keshilli Botues:

Xhafer Dobrusha,

Bajram Kruja,

Lumturi Mataj,

Defrim Spahiu,

Petref Çelaj,

Aleks Dushi,

Stavri Liko, Kryeredaktor

Mendimi i SPASH-it për rritjen e pagave për vitin 2006

Sindikata e Pavarur e Arsimit Shqiptar, SPASH, vlerëson jo vetëm vendimin e fundit të qeverisë shqiptare për rritjen e pagave të mësuesve në sistemin e arsimit parauniversitar por, cilindo vendim qeverie që vlerëson mundin dhe djersën e mësuesve nëpërmjet shpërblimit dhe rritjes së pagës së tyre.

Në statutin e SPASH është vendosur një thënie e Ciceronit: "Cili profesion fisnik është më i vlefshëm për shtetin se sa ai i njeriut që edukon brezin që rritet?"

Neni 109/1 i ligjit për Kodin e Punës së RSH-së thotë: "Me pagë kuptohet paga bazë si dhe shtesat me karakter të përhershëm". Në këtë kuptim, paga e 13-të është marrë me përpjekje jo të vogla sindikaliste të cilat u kurorëzuan me sukses me Vendimin e Qeverisë Nr. 601 datë 17.11.2000, i cili është ndryshuar po me Vendim të Qeverisë Nr. 446 datë 09.07.2004, e që do të thotë se: "Punonjësve nësimorë të sistemit parauniversitar u jepet çdo vit një shpërblim i barabartë me një pagë mujore neto".

Plotësimi i kësaj kërkesë, si të gjitha kërkesat sindikaliste për rritje pagash, ishte motivimi në i mirë për mësuesit, meqenëse nuk mund të ndryshonin kategoritë e pagave.

Ky shpërblim bëri xhelozë disa Ministri dhe Sindikata të ndryshme të cilat thoshin: "Sa mirë, mësuesit marrin pagë të 13-të në fund të vitit".

Kohët e fundit ka patur disa mendime që jo të gjithë mësuesit e meritojnë shpërblimin, duke propozuar që, mbi bazën e

vlerësimeve të kontrollit që kryen MASH ose DAR, mësuesve t'u jepet nga 60% deri 100 % e kësaj page.

Këtë nuk mund ta pranonte SPASH, prandaj u shpreh dakord që ky shpërblim të futej në pagë dhe ta përfitonin të gjithë mësuesit.

Më 30 mars 2006 Departamenti i Administratës Publike relatoi për diskutim katër projekt vendime për rritjen e pagave në sistemin buxhetor: Projektvendimi me Nr. 543/2 datë 30 mars 2006 rrit pagat e punonjësve nësimor në arsimin parauniversitar në masën 27.4 %.

Kjo rritje e pagave në masën 27.4 %, do bëhet në dy periudha: në 15 prill 2006 mesatarisht paga do të rritet me 16.6 %, ndërsa në 1 korrik 2006 ajo do të rritet mesatarisht 10.8 %, gjithsej është 27.4 %.

Me rritjen e pagës mujore sipas këtij projektvendimi, propozohet që, duke filluar nga data 15 prill 2006, në pagën mujore të përfshihet paga e 13-të e çdo punonjësi nësimor në arsimin parauniversitar. Deri këtu, SPASH shprehet plotësisht dakord.

Po të krahasojmë pagën bruto, (se vetëm kështu bëhen llogaritë financiare), para 15 prillit dhe pas 1 korrikut 2006 do të dallojmë se: Paga e mësuesit fillestar në Shkollën e Mesme ishte 21.540 lekë, (pa përfshirë efektet e pages se 13-te), sipas vendimit të nësipërm bëhet 28.150 lekë. Paga e një mësuesi me mbi 20 vjet vjetërsi në punë ishte 28.064 leke, (pa përfshirë efektet e pages se 13-te), sipas këtij

vendimi bëhet 35.185 lekë.

Paga e një mësuesi fillestar në Shkollën 9-vjeçare ishte 19.220 lekë, (pa përfshirë efektet e pages se 13-te), sipas këtij vendimi rritet në 25.150 lekë.

Paga e një mësuesi me mbi 20 vjet vjetërsi në punë ishte 25.744 leke, (gjithnjë pa përfshirë efektet e pages se 13-te), sipas këtij vendimi bëhet 32.185 lekë.

Është e vërtetë që shifrat nuk korrespondojnë me përqindjet, por rritja e pagës si në sipër është një përmirësim i ndjeshëm në vlerësimin e mësuesit.

Kërkesa e Sindikatës së Pavarur të Arsimit, për një vlerësim moral dhe material për punën e mësuesit do të jetë e përhershme, derisa ajo të krahasohet me vendet perëndimore.

Përsa i përket pjesës së vendimit që mësuesit e Matematikës, Fizikës dhe Informatikës në Shkollat e Mesme dhe mësuesit e Matematikës dhe Fizikës në Shkollat 9 vjeçare diferencohen në pagë në masën 1.200 lekë në muaj, SPASH nuk mendon se është e drejtë, për arsye se për diplomë të barabartë, për punë të barabartë me nxënësit në klasë, duhet të ketë vlerësim të barabartë.

Për këtë problem, ne do të vijojmë të kërkojmë me këmbëngulje të diskutojmë me Ministrinë e Arsimit e Shkencës dhe Ministrin Pollo, ashtu siç ka premtuar publikisht, deri në nënshkrimin e Kontratës Kolektive të Punës, duke thithur dhe mendimet e mësueve.

Arsimimi cilësor për të gjithë, një prioritet në Shqipëri

Shqipëria, një vend i vogël, me një sipërfaqe prej 28 mijë km² dhe me një popullsi prej rreth 3.3 milionë banorë, konsiderohet si një vend arsindashës.

Në Kushtetutë përcaktohet se "kushdo ka të drejtën për arsimin" dhe se "arsimimi në shkollat publike është falas". Me ligj, duke filluar nga viti shkollor 2004-2005, arsimi i detyrueshëm është 9-vjeçar, pas një periudhe prej rreth 50 vjetësh me arsim të detyrueshëm 8-vjeçar. Qeveria aktuale, e mbështetur edhe nga Banka Botërore, e ka shpallur arsimin prioritet, ka pranuar Strategjinë e miratuar për zhvillimin e sistemit arsimor deri në vitin 2015 dhe është angazhuar publikisht që të dyfishojë pjesën e GDP për arsimin, (e cila në dhjetë vjetët e fundit ka qenë mesatarisht 3 përqind) dhe pagat e mësuesve gjatë mandatit të saj 4-vjeçar, deri në vitin 2009.

Aktualisht 467 000 nxënës janë të regjistruar në sistemin e arsimimit të detyrueshëm 9-vjeçar në Shqipëri, mbi 80 përqind e të cilëve vazhdojnë shkollat e mesme të të gjitha kategorive dhe rreth 75 përqind a tyre që mbarojnë këto shkolla vazhdojnë arsimin e lartë.

Mbi 40 mijë mësues e pedagogë japin mësim në të gjithë sistemin arsimor në Shqipëri, pjesa më e madhe e të cilëve të diplomuar për nivelet përkatëse, me disa përjashtime në zonat e thella rurale, ku ka mjaft mësues pa arsimin përkatës. Në qytetet e mëdha të vendit nuk ekziston problemi i mungesës së mësuesve të mjaftueshëm, përkundrazi në shumë

se 7 000 mësues presin për një vend pune në sektorin e arsimimit.

Por, treguesit sasiorë, në përgjithësi të kënaqshëm, të zhvillimit të arsimimit në Shqipëri, nuk kanë ecur dhe akoma nuk po ecin me të njëjtin ritëm dhe me të njëjtin intensitet me treguesit cilësor. Mësuesit shqiptarë ndeshen me probleme e vështirësi të shumta, të cilat burojnë nga stadi aktual ekonomik e social i zhvillimit të vendit, nga vlerëja që shteti dhe shoqëria i kushtojnë arsimimit, por edhe nga niveli e përbërja e vetë mësuesve.

Janë hartuar kurrikulat e reja, të cilat u krijojnë në shumë hapsirë mësuesve, i lejojnë dhe inkurojnë ata për në shumë punë krijuese, krahasuese, përzgjedhëse në orën e nësimimit, por zbatimi i plotë i tyre është një proces kompleks dhe që kërkon, jo vetëm kohë, por edhe kushte. Është në proces hartimi i teksteve të reja, botimi i të cilave është liberalizuar dhe është futur sistemi i konkurrencës midis autorëve, por e tërë kjo punë kërkon një konceptim të ri, kërkon ndryshim e përshtatje nga mësuesit, kërkon që ata të heqin dorë nga metodat e vjetra të mësimdhënies dhe të bëjnë atë kapërcim të nevojshëm për ta konsideruar nxënësin, jo vetëm objekt, por edhe subjekt aktiv të orës së nësimimit.

Shumë evidente janë vështirësitë që ndeshin mësuesit për të përballuar kërkesat e këtij procesi të ri të arsimimit cilësor, sepse shumë nga ata kanë mbetur mbirapa dhe kanë nevojë të mësojnë vetë, përpara se të mësojnë nxënësit; kanë nevojë

për kualifikim. Nuk mund të thuhet se Qeveria dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës, që kanë hartuar e miratuar Strategjinë për një arsim cilësor, e kuptojnë si duhet nevojën jetike që kanë mësuesit e vjetër e të rinj për kualifikim të vazhdueshëm, prandaj kërkesat për përmirësime të dukshme në këtë drejtim vijnë nga shumë subjekte, përfshirë edhe sindikatat.

Akoma mjediset shkollore dhe baza laboratorike janë të pamjaftueshme dhe lenë shumë për të dëshinuar. Është e vërtetë që gjatë këtyre 15 vjetëve të tranzicionit janë rindërtuar e rehabilituar rreth 80 përqind e shkollave të vendit, sidomos me ndihmën dhe mbështetjen e donatorëve të jashtëm, megjithatë, kryesisht për shkak të mungesës së godinave, sidomos në qytetet e mëdha, si Tirana, Durrësi, Shkoderë apo Vlora, mësuesit janë të detyruar të punojnë me një numër të madh nxënësish në klasë, që jo rrallë arrijnë deri 5 - 50 nxënës. Për më tepër, shumë nga këto shkolla, kur i vështron nga jashtë, si godina, nuk dallojnë shumë nga shkollat e vendeve evropiane të zhvilluara, por, kur hyn në klasa, befasohesh. Shikon vetëm mure bosh, me shumë pak mjete mësimore dhe pothuaj pa asnjë laborator.

Në këto kushte, edhe mësuesi në i mirë, më i kualifikuar, është i detyruar të bëjë në klasë vetëm monolog, nuk ka se si të demonstrojë e provojë ato që thotë dhe nuk ngjall interesim tek nxënësit për njohuritë që përpiqet të transmetojë.

Edhe motivimi i mësuesve nuk u përgjigjet rëndësisë së profesionit dhe punës së madhe që ata bëjnë në shkollë e jasht saj. Akoma paga e mësuesve është shumë e ulët, mesatarisht 22.000 leke, (rreth 180 Euro), në muaj. Pas kërkesave insistuese të sindikatave, për vitin 2006, Qeveria ka pranuar një rritje të pagave prej 20 përqind, duke filluar nga muaji prill, ndërkohë që është duke u negociuar me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës mundësia për një motivim të diferencuar të mësuesve mbi bazën e punës së bërë, rezultateve të arritura dhe kontributit në lëvizjen sindikale.

Megjithëse likuidimi i analfabetizmit në Shqipëri është shpallur që në vitin 1956, akoma në shkallë vendi, sidomos në zonat e thella rurale, por edhe në periferi të disa qyteteve të mëdha, ku janë vendosur një numër i madh familjesh që kanë zbritur nga zonat e thella rurale, është rishfaqur ky fenomen, si edhe ai i braktisjes së shkollës, pa e nbaruar arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar.

Në shkallë vendi aktualisht nuk frekutojnë shkollën 1.5 deri në 2 përqind e nxënësve të arsimit të detyrueshëm, ose, thënë ndryshe, rreth 8 - 9 mijë nxënës, ndërkohë që nuk ka statistika të sakta për numrin e fëmijëve të moshës shkollë që mund të mos jenë regjistruar fare për të vazhduar shkollën dhe rrezikojnë të mbeten analfabetë.

Fenomeni i braktisjes bëhet më i mprehtë, kur zoret në disa zona, sic janë periferia e qytetit të Tiranës, rrethi i Shkodrës, i Fierit, i Elbasanit, i Durrësit dhe Korçës, ku e braktisin shkollën nga 800 deri në 1 500 nxënës.

Përveç shkaqeve ekonomike e familjare, nxënësve me probleme, me prindër të ndarë, me njërin nga prindërit ose pa prindër fare, shpëtësuese janë braktisjet nga komuniteti rom, ato për gjakmarje dhe, në disa zona, e braktisin shkollën nxënësja vajza në klasat e 7-ta, të 8-ta ose të 9-ta, të cilat i detyrojnë familjet, me pretekstin se janë rritur dhe janë shumë të zhvilluara nga ana trupore.

Shumica dërmuese e nxënësve që e kanë braktisur shkollën ose viçojnë me hope janë të angazhuar në punë.

Nga studimet e bëra, mund të nxirret konkluzioni se rreth 50 mijë fëmijë në shkallë vendi janë të angazhuar në punë, duke filluar që nga ato më të thjeshtat e deri tek punët e vështira e të rrezikshme.

Duke e parë më në thellësi këtë fenomen, një shembull kuptimplotë na e jep zona e Bathores, fare afër, në periferi të Tiranës, ku këto vitet e fundit janë vendosur shumë familje të ardhura nga zonat e thella veriore, me një popullsi prej rreth 25 mijë banorësh. Nga 1 477 fëmijë të moshës shkollë, në këtë zonë është evidentuar se e kanë braktisur shkollën 84 nxënës, nuk janë regjistruar fare në shkollë 16 fëmijë, ndërkohë që pjesa dërmuese e tyre punojnë. Përveç kësaj, një numër prej 400 - 500 nxënësish të kësaj zone janë të angazhuar në punë para ose pas orëve të mësimi, gjë që u shkakton atyre vështirësi të shumta për nbarëvajtjen në mësim.

Për më keq akoma, në disa zona, sidomos në rrethet veriore të vendit, si Shkodër, Kukës, Tropojë, Dilber, Pukë, Mirditë, Mat, Lezhë etj, është rigjallëruar fenomeni i gjakmarjes, i cili është një pengesë e madhe për

shkollimin. Për këtë arsye, një kontingjent i veçantë i fëmijëve të moshës shkollë, rreth 2 000, sipas statistikave jo aq shumë të verifikuara, janë larguar nga shkolla në mënyrë të pavullnetshme, duke qenë të detyruar të ngujohen, (të mbyllen në shtëpi), për shkak të gjakmarjes.

Në qytetin e Shkodrës, për shembull, është një lagje me dhjetëra fëmijë të ngujuar për shkak të këtij fenomeni. Vetëm në një nga këto familje janë gjastë fëmijë të tillë, që nuk i ndjekin mësimet. Kjo ka mbodhur sepse djali i shokut të tyre ka kryer një vrasje dhe është larguar jashtë shtetit, duke i lënë, kështu, të gjithë pjesëtarët e familjes të ngujuar, në hamëri.

Përballë kësaj situatë dhe këtyre problemeve, krahas organeve shtetërore dhe institucioneve arsimore, edhe sindikatat e arsimit, FSASH e SPASH, të mbështetura edhe nga disa organizata simotra, sidomos nga sindikata e arsimit e Holandës, AOB, janë plotësisht të angazhuara, jo vetëm për mbrojtjen e interesave social-ekonomike të mësuesve dhe zhvillimin e sistemit arsimor në Shqipëri, por edhe për trajnimin e mësuesve sindikalistë, të cilët punojnë konkretisht në terren me nxënësit që kanë braktisur shkollën ose që janë në rrezik për ta braktisur atë, nëpërmjet ngritjes së opinionit të mësuesve dhe aktivizimit më të mirë të tyre, me qëllim që edhe në Shqipëri të realizohen sa më parë synimet dhe kërkesat e bashkësisë ndërkombëtare për një arsim cilësor për të gjithë.

Shënim: Materiali është përgatitur nga një grup studimor i sindikatave të arsimit.

Aktivitetet në kuadrin e Javes së Veprimeve Globale për Arsimin në Shqipëri

Është viti i katërt radhazi që sindikatat tona të arsimit, FSASH dhe SPASH janë përfshirë në aktivitetet e organizuara në kuadrin e Javes së veprimeve Globale për Arsimin. Të mbështetura edhe nga Federata Ndërkombëtare e Arsimit, EI, këtë vit ato organizuan me shumë aktivitetet me një pjesëmarrje në të gjërë të mesuesve e nxënësve, jo vetëm në Tiranë, por edhe në disa rrethë.

Me kryesoret nga këto veprimtari janë:

KONFERENCA PËR SHTYPIN

Si pjesë e rëndësishme e Koalicionit Shqiptar për Arsimimin e

Kjo Konferencë u kthye edhe në një bashkëbisedim midis përfaqësuesve të Koalicionit, në lidhje me koordinimin e veprimeve në këto

sindikatat dhe gjithë aktoret e tjera që janë të interesuar për arsimimin e brezit të ri, si qeveritë, shkollat, shoqëri civile, etj. Qëllimi i kësaj levizjeje, ku prej disa vitesh është angazhuar edhe FSASH është ngjallja e interesit të shoqërisë për mesuesit dhe nxënësit, që të kemi mesues të kualifikuar që t'u përgjigjen sfidave të shkollës që ka nisur, që të mos ketë asnjë nxënës që të mbetet pa u arsimuar. Në këto kuadër, dy sindikatat e arsimit kanë zhvilluar këto ditë dhe do të zhvillojnë në ditët që vijne aktivitetet të shumta, sidomos në Tiranë, Durrës e rrethë të tjera të vendit".



fëmijëve, të krijuar posaçërisht për aktivitetet e kësaj Jave dhe që përfshijn 10 organizatat më të rëndësishme që veprojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, përfaqësues të të dy sindikatave të arsimit, FSASH e SPASH, morën pjesë në Konferencën për Shtyp që u organizua në Hotel Tiranë International, në datën 25 prill, ditën e hapjes së kësaj Jave.

Nepërmjet një Deklarate për Shtypin që u lexua, në emër të Koalicionit, nga zoti Altin Hëzizaj, u shpallën aktivitetet kryesore të planifikuara për këtë Javë.

I pranishëm në këtë Konferencë, Kryetari i FSASH-it, zoti Xhafer Dobrushit, theksoi angazhimin e sindikatave të arsimit dhe të mesuesve për uljen e numrit të nxënësve që braktisin shkollën dhe eliminimin e punës së fëmijëve, duke shpallur edhe aktivitetet që sindikatat e arsimit kishin planifikuar në kuadrin e Javes së Veprimeve Globale.

fushë, jo vetëm gjatë ditëve të Javes së Veprimeve Globale, por edhe në vazhdimësi të punës dhe veprimtarisë së tyre të përditshme.

TAKIMI KOMBËTAR I FSASH-it

Problemet e Javes së veprimeve Globale për Arsimin ishin objekt edhe i Takimit Kombëtar që u organizua në një nga sallat e Muzeut Historik Kombëtar, në rastin e

15 - Vjetorit të themelimit të FSASH-it.

Duke folur për këtë çështje, në prani të anëtarëve të Këshillit Drejtues të FSASH-it dhe të njëjtit aktivistëve që e themeluan dhe morën pjesë në aktivitetet e vazhdueshme të kësaj Federate dhe të disa ish ministrave të arsimit, zoti Xhafer Dobrushit theksoi:

"Festa jonë sot përkon me ato ditë që tashmë kanë marrë emrin Jave të Veprimeve Globale për Arsimin. Kjo është një levizje botërore që përfshinë

TAKIMI INTERESANT ME MESUES E NXËNËS NË HOTEL TIRANË INTERNATIONAL

"Çdo fëmijë ka nevojë për mesues", ishte tema që përcolli Takimin e organizuar nga dy sindikatat e arsimit shqiptarë, në kuadrin e "Javes së Veprimtarive Globale për Arsimin 2006". Në takim morën pjesë mbi 60 nxënës, mesues e drejtues të sindikatave nga katër rrethë ku punohet për eliminimin e punës së paligjshme të fëmijëve. Nëqoftëse afërsisht në të gjithë rrethet, pjesëmarrësit në takim evidentonin pothuaj të njëjtat probleme, eksperiencat e punës ishin të ndryshme. Kjo bëri që takimi të ishte frytëdhënës dhe të shoqërohej me një bashkëbisedim ndërmjet mesuesve dhe nxënësve pjesëmarrës. Takimin e hapën drejtuesit e FSASH e SPASH, Xhafer Dobrushit e Bajram Kruja. Në vijim, sekretari i Përgjithshëm i

FSASH, Stavri Liko, bëri një prezantim të Javës së Veprimeve Globale 2006, duke u ndalur edhe tek aktivitetet që organizojnë këtë vit dy sindikatat shoqërore të arsimit.

Bisedën e filloi Afërdita Lusha, mësuese nga Elbasani, e cila solli dy eksperiencat: puna në grup e të gjithë mësuesve të një shkolle dhe në mënyrë të veçantë, njohja me problemet dhe hallat e fëmijëve dhe familjeve të tyre. Kolegia e saj Mariza Strati, u ndalë në aftësinë e mësuesve për të njohur dhe hyrë në botën e brendshme të fëmijëve, si edhe ne nevojën për të përcaktuar atë çfarë u mungon ose i pengon ata. Fëmijët janë subjekt i punës sonë. Puna individuale është shumë rezultative. Mësuesi Derall Tota, nga Tirana, u ndal në një problem shumë të rëndësishëm, të cilin e shoqëroi dhe me përvojën e tij, sic është bashkërendimi i punës me aktore të interesuar për këtë çështje dhe në mënyrë të veçantë me pushtetin qendror e vendor. Kjo tërë ngjalli interes dhe perfshiu në bashkëbisedim shumë pjesëmarrës. Në përgjithësi, mësuesit shprehën pakënaqësinë e tyre lidhur me veprimtarinë dhe mundësitë e të dy këtyre pushteteve për kufizimin e punës së paligjshme të fëmijëve. Mësuesja Gazmira Birçaj nga Fieri foli

për eksperiencën e saj duke parashtruar një pyetje: "A vijnë fëmijët me qejf në shkollë?" Kjo pyetje bëri që të diskutohet për profesionin e mësuesit, kualifikimin e vazhdueshëm të mësuesve, gjendjen e lokaleve shkollore, marrëdhëniet ndërmjet nxënësve, integrimin e nxënësve të ardhur nga zonat malore në zonat urbane, mënyrës se si mësuesit sillen me nxënësit në shkollë, mundësitë që nxënësit të arrijnë nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme kulturore, shkencore, artistike dhe sportive, në lidhje me të cilat e gjithë veprimtaria në shkollë është e paplotë. Në këtë pikë u ndalua më shumë tek figura e mësuesit si mësuesimorës, në përputhje me kushtet aktuale, rregullat bashkohore të mësimit, si një edukator i zoti, si një prind dhe në mënyrë të veçantë, si një qytetar i cili ka marrë përsipër një nga detyrat më të vështira dhe më pak të paguara. Mësuesja Rajmonda Lekaj, Shkodër, evidentoi se, lidhur me nxënësit që nuk vijojnë shkollën dhe ata që kryejnë punë të paligjshme, rruza kryesore është puna me prindërit. Prindërit kanë problemet e tyre që mund të grupohen në ekonomike, sociale, në formimin e tyre kulturor dhe pedagogjik, shoqëror e deri në mungesën e tyre. Prindërit të gjithë ëndërojnë për fëmijët e tyre.

Të bashkëpunosh me ta për të mirën e fëmijëve të tyre është njëllë sikur jo vetëm t'u rikthesh ëndrën e humbur, por t'u hapësh rrugën që ëndrra e tyre të bëhet realitet.

Takimi u shoqërua edhe me dëshirën për të shtruar probleme të tjera që shqetësojnë sindikalistët, por ribeti gjithësesi në kuadrin e problemit për të cilin ishte thimur.

Shumë kuptimplotë ishin fjalët e një nxënëseje romë, Abina Gjollaj nga Elbasani: "Në shkollë u ktheva me ndihmën dhe punën e mësuesve të mija. Në fillim kisha frikë nga fyerjet që mund të më bëheshin si romë. Ndërsa tani kam vendosur të vazhdoj juridikun. Dua të bëhem avokate. Më në mirë mësueset e mija, ndërsa unë dua të mirë të fyerit".

TAKIM ME MËSUES NE DURRES

Mësues aktive në punën me nxënësit që kanë probleme në vijim dhe në përvetësimin e lendeve mësimore nga rrethet Durrës, Kavajë e Krujë, morën pjesë në Takimin e organizuar në Durrës në kuadrin e aktiviteteve të Javës së Veprimeve Globale për Arsimin.

Në Takim morën pjesë edhe Kryetari i FSASH-it, zoti Xhafer Dobrushi dhe Zv/Kryetari i SPASH-it, zoti Refikim Shahu.

Në lidhje me Javën e Veprimeve Globale, si edhe për angazhimin e FSASH-it e SPASH-it, pjesëmarrësve në Takim u foli Sekretari i Përgjithshëm i FSASH-it, Stavri Liko, i cili u ndalë veçanërisht tek problemet me të cilat përballen nxënësit e mësuesit shoqërore dhe tek kërkesat e dy sindikatave të arsimit për mirëmbajtjen e buxhetit për arsimin, motivimin e mësuesve dhe angazhimin e shoqërisë civile për problemet e arsimit.

Mësuesit pjesëmarrës në takim shprehën angazhimin për një punë më të mirë në të ardhmen me kolegët e



U festua 15 - Vjetori i FSASH-it

Me datën 26 prill, në një nga sallat e Muzeut Historik Kombëtar, u festua 15 - Vjetori i themelimit të Federatës së Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës, FSASH, e cila u krijua plotë

si edhe ish Ministri dhe Arsimit Thoma Deliana, Skender Gjinushi, Ylli Vejsiu e të tjerë.

Në fjalën përshëndetëse në këtë rast, Kryetari i FSASH-it, zoti Xhafer

saj. Faqe me rëndësi në veprimtarinë e FSASH do të mbetet levizja sindikale që u zhvillua në janar 1999. Levizje të rëndësishme sindikale janë zhvilluar edhe në nëntor 2000, shtator

madh për një arsim cilësor publik, në punën me mesuesit e rinj dhe me mesueset gra, në përpjekjet për të minimizuar e eliminuar punën e fëmijëve, për të kthyer në shkollë nxënësit që e braktisin atë dhe për të rindënuar e motivuar me mirë mesuesin.

Në moshën 15 vjeçare, FSASH është e përgatitur për të përballuar sfidat e reja që e presin dhe do të jenë të synimet që i ka vënë vetes, midis të cilave edhe nënshkrimin e Kontrates së re Kolektive të Punës, miratimin e Statusit të mesuesit dhe Statusin e Stafit Akademik, dialogimin me MASH për problemet e sistemit të pagave e shpërblimeve, fuqizimin e vete Federatës etj.

Në këtë ceremoni përshëndetën edhe ish Ministri dhe Arsimit Deliana, Vejsiu e Gjinushi, të cilët vlerësuan veprimtarinë dhe rolin që ka luajtur e luan FSASH për mbrojtjen social ekonomike të mesuesve, për reformimin dhe modernizimin e arsimit në vendin tonë, për zgjidhjen e shumë problemeve që preokupojnë sot shkollën dhe arsimin në Shqipëri.

Festimi i 15-vjetorit të themelimit ishte edhe një rast tjetër për të konfirmuar vazhdimin e angazhimeve të FSASH për mbrojtjen e anëtarëve të vete mesues dhe për zhvillimin e sistemit arsimor në vendin tonë.



15 vjet në parë, si shprehje e vullnetit të mesuesve, pedagogëve dhe punonjësve të shkencës, për të përballuar kërkesat e reja që shtriheshin para tyre, në kushtet e reja të vendosjes dhe zhvillimit të pluralizmit politik në vendin tonë.

Në ceremoninë festive të organizuar në këtë rast, merrnin pjesë anëtarët e Këshillit Drejtues të Federatës, ish drejtues qendror e lokalë, themelues të kësaj Federate, Kryetari i KSSH-së zoti Kol Nikollaj, drejtues të Federatave të tjera në përberje të KSSH, drejtues kryesorë nga Sindikata e Pavarur e Arsimit Shqiptar, SPASH,

Dobushi, midis të tjerëve, vuri në dukje se në këtë 15 vjet të ekzistencës së saj FSASH, nëpërmjet veprimëve të shunta sindikale, ka mundur arritjen dhe plotësimin e shumë prej synimeve të ideuara që në mbledhjen e parë themeluese të saj, duke rëndësuar levizje të shunta sindikale.

Levizja e parë në kuadrin e FSASH, theksoi ai, është zhvilluar në qershor 1992 dhe synonte rritjen e pagave të mesuesve të të gjithë kategorive. Në vitet 1992-1996 FSASH ka bërë shumë përpjekje për të ekzistuar, për të përballuar goditjet që i vinin nga shumë anë dhe arriti të hedhë bazat e organizimit të

2001, dhjetor 2004, etj. Si rezultat, pagat e mesuesve janë dyfishuar, në krahasim me vitin 1998 dhe janë shënuar një sërë arritjesh të tjera, të ligjënara edhe nëpërmjet Kontratave Kolektive të Punës të nënshkruara me MASH.

Duke u ndalur tek zgjerimi i vazhdueshëm i veprimtarisë së FSASH-it, zoti Dobushi theksoi se që prej disa vitesh, ajo ka dalë nga kuadri i njëanshëm i interesave thjeshtë ekonomike të mesuesve dhe është përfshirë aktivisht, me gjithë potencialin e saj intelektual të anëtarëve që përfaqësojnë, në procesin e reformimit dhe modernizimit të arsimit, me synimin e

Diskutime konkrete dhe programe pune per te ardhmen

Nga seminari zonal ne Korçe

Me pjesemarrjen e drejtuesve lokale te FSASH e SPASH nga rrethet Korçe, Devoll, Kolonje e Pogradec, u zhvillua ne Korçe seminari trajnues zonal ne kuadrin e aktiviteteve te programit me AOB/FNV.

Ne seminar u gershetuan trajtimet teorike me diskutimet konkrete dhe perpunimin e programeve per punen ne te ardhmen, bazuar ne problematiken specifike te secilit prej seksioneve sindikale te rretheve pjesemarrrese.

Pas fjales se hapjes nga kryetari i FSASH-it Z. Xhafer Dobrushit dhe Zv/Kryetari i SPASH-it, Z. Defrim Spahiu, teta e pare u zhvillua nga koordinatori i Projektit Stavri Liko. Mesqese ajo kishte te bente me domosdoshmerine e fupizimit te sindikatave te arsimit ne nivel rrethi e shkolle, shpjegimi teorik u pergjendrua sidomos tek tezat: "Sindikata jane anetaret", "Sindikatat mund te jene efektive vetem kur ato funksionojne nbi bazen e rregullave te percaktuara qarte ne statutet

perkatese", "S'mund te kete sindikata te forta pa kontributin e anetareve per forcimin e gjendjes financiare te tyre",

ceshtje te tjera, te cilat u bene objekt diskutimi, pas referimeve te secilit grup. E perbashketa e diskutimeve per



"Roli i drejtuesit ne nivel lokal, baza per sindikata rezultative".

Puna ne grupe evidentoi probleme, por edhe pervoja ne lidhje me keto e

keto ceshtje ishte nevoja e nje pune konkrete, forcimi i bashkepunimit midis dy sindikatave te arsimit dhe

Vijon në faqen 11

Aktivitete ne kuadrin e Javes se Veprimeve Globale per Arsimin ne Shqiperi

Vijon nga faqja 3

tyre mesues, anetare te te dy sindikatave te arsimit, per problemet qe lidhen me mbrojtjen e femijeve dhe per shmangien e rasteve te braktisjes se shkolles ose te rrezikshmerise qe ekziston per ringjalljen e anal-fabetizimit, sidomos ne disa fshatra te zonave te thella.

Takimi u kthye ne nje bashkebisedim, sidomos per problemet me te cilat perballen mesuesit e ketyre zonave, duke kerkuar nje angazhim me te mire, si te strukturave drejtuese te sindikatave ne qender e ne rrethe, ashtu edhe te vete mesuesve anetare te tyre.

AKTIVITETE TE TJERA TE ORGANIZUARA NE KUADRIN E KOALICIONIT

Moi 2 000 femije nga shkollat e Tiranës moren pjese ne Forumet e organizuara nga Senati i Femijeve te Tiranës, Bashkia e Tiranës dhe Qendra per te Drejtat e Femijeve te Shqiperise, (CRCA). Drejtues te Senatit mbajten leksione dhe organizuan forume me pjesemarrjen e nxenesve te shkollave perkatese, ndezkthe qe shume femije te tjere moren pjese ne diskutime dhe ne konkurset e titulluara "Mesuesi im icel"

Klubi i CRCA per Luften kunder Punes se Femijeve, ne bashkepunim me Shkollen "Dhora Leka" ne Tirane, organizuan gjate kesaj Jave aktivitete te perbashketa, sidomos ne periferi, ku ajne edhe zonat me te varfera te Tiranës. Moi 1 000 femije kane marre pjese ne keto aktivitete, te cilat perfshinin edhe hapjen e nje ekspozite pikturash me teme "Mesuesi im". Te gjitha pikturat jane realizuar nga nxenesit e kesaj shkolle dhe ata te Klubit te Femijeve.

Aleks Dushi
Stavri Liko

Per nje perfshirje me te organizuar te sindikatave te arsimit ne zbatimin e procesit te Bolonjes

Nga seminari me sindikaliste e pedagoge te arsimit te larte

Me mbështetjen e drejtperdrejt te Federates Nderkombetare te Arsimit, EI, dy sindikatat shoqiptare te arsimit, FSASH e SPASH, organizuan ne Hotel Tirana International, nje seminar me pjesemarrjen

problemet qe kane te bejne me procesin e Bolonjes, si edhe me ceshtje te tjera qe lidhen me zhvillimin e arsimit te larte ne vendin tone.

Ata kerkuan qe MASH dhe

studentet, por edhe tek disa pedagoge ose edhe departamente ne shkollat e larta.

Ne diskutimin e vete perfaqesuesi i Qeverise Studentore, Dritan Nelaj, theksoi se duhet te studiohet edhe mundesia e perfshirjes se punes se pavarur te studenteve, duke u llogaritur ajo si pjese e krediteve, sipas pervojave europiane qe ekziston ne lidhje me kete ceshtje.

Ne diskutimin e saj ne kete seance, perfaqesuesja e EI, Zj. Monique Fouilhoux vuri ne dukje rëndesine e nje angazhimi me te mire te sindikatave ne kete sektor, sidomos per kualifikimin e pedagogeve, ne menyre qe ata ta kuptojne rolin e tyre te rëndesishem si njera prej tre shtyllave te procesit te Bolonjes. Ajo theksoi angazhimin e EI per te ndihmuar dy sindikatat shoqiptare, anetare te saj, FSASH e SPASH, per te rritur ndikimin e tyre ne radhet e pedagogeve, anetare te ketyre sindikatave, per nje rol me efektiv te tyre ne procesin e Bolonjes dhe ne zhvillimin e arsimit te larte ne teresi ne Shqiperi.

Ne kete seance u theksua, sidomos, nevoja e nje bashkepunimi me te mire midis sindikatave te arsimit dhe Qeverise Studentore, si nje kusht i domosdoshem per te krjuar nje front te perbashket pedagoge - studente ne procesin e zbatimit te Deklarates se Bolonjes.

Ne fjalen e vete ne mbyllje te Seminarit, duke bere nje pëmbledhje te problemeve qe u diskutuan gjate dy diteve te tij, zoti Xhafer Dobushi paraqiti disa nga prioritetet dhe rekomandimet per punen e sindikatave te arsimit ne lidhje me zhvillimet ne arsimin e larte, duke u ndalur sidomos ne organizimin dhe strukturimin me te mire te sindikatave ne arsimin e larte, ne pjesemarrjen aktive te sindikatave per hartimin e ligjit per arsimin e larte, per hartimin e draf titte Statusit te stafit akademik, per punen e vecante me asistente- pedagoge, duke pare me prioritet motivimin me te mire te tyre, shpejtimi i procedurave per hartimin e Kontratave Kolektive te Punes, ndertimi i marredhenieve me funksionale me studentet dhe organizatat e tyre, etj.



e perfaqesuesve te tyre ne arsimin e larte, duke ftuar edhe disa perfaqesues te Sindikates se Punonjesve te Arsimit te larte.

Objekt shpjegimesh e diskutimesh ne kete Seminar ishin problemet qe kane te bejne me rritjen e rolit te ketyre sindikatave per zbatimin e procesit te Bolonjes ne vendin tone.

Ne seminar merrte pjese edhe koordinatori e EI per arsimin e larte. Zj. Monique Fouilhoux, e cila ndihmoi nga afer edhe per pergatitjen dhe zhvillimin e seminarit.

Perfaqesuesi i MASH, Z. Valjer Peshkopia, pedagogu i Universitetit Bujqesor, Z. Rexhep Çuko, Kryetari FSASH-it, Z. Xhafer Dobushi, Kryetari i SPASH, Z. Angjelin Shtjefni trajtuan temat rreth situaten aktuale ne arsimin e larte dhe stadin e zbatimit te procesit te Bolonjes ne vendin tone, rreth gjendjen e zbatimit te procesit te Bolonjes ne Universitetin Bujqesor dhe ndikimin e tij tek stafi akademik, rreth Statusin e stafit akademik dhe kushtet e punes e lirine akademike.

Pjesemarrjesit ne seminar shprehen mendime dhe bene vrejteje e propozime per angazhimin e sindikatave te arsimit ne

institucionet e tjera perkatese te perfshirje ne menyre te organizuar perfaqesuesit e sindikatave ne te gjitha procedurat, takimet, konsultimet e vendimarrjet qe kane te bejne me procesin e Bolonjes dhe me zhvillimet e tjera ne arsimin e larte ne Shqiperi.

Me shume interes ishte seanca e perbashket me perfaqesues te studenteve, ku muaren pjese edhe drejtues te ESIB, (Sindikatat Kombetare te Studenteve ne Europe), me qender ne Bruksel, Michael Horge dhe Colin Tuck, si edhe perfaqesues te Qeverise Studentore te Shqiperise, Dritan Nelaj etj.

Pas referimeve ne lidhje me mundesite e punesimit te studenteve qe diplomohen ne Shqiperi, nga perfaqesuesi i MASH dhe perfaqesuesit e studenteve, u bene shume diskutime, ku mbizoteri ideja se me studentet duhet te behet nje pune me te organizuar, jo vetem nga Qeveria Studentore, por edhe nga sindikatat, nga vete departamentet dhe institucionet e tjera perkatese, per njohjen e tregut te punes, per vlerat e diplomave te reja dhe mundesite e punesimit te studenteve qe diplomohen ne vendin tone, mbasi ka shume papartesi ne keto drejtime, jo vetem tek

Me shume pergjegjesi e perkushtim per plotesimin e kerkesave te anetareve

Nga mbledhja e Keshillit Drejtues te FSASH-it

Keto dite u zhvillua mbledhja e Keshillit Drejtues te FSASH, ku u be analiza e punes per vitin 2005 dhe u percaktuan drejtimet kryesore te veprimtarise se saj per vitin 2006.

Ne fjalen hyrese qe mbajti kryetari i Federates, zoti Xhafer Dobrushki, vuri ne dukje angazhimet e Kryesise dhe te Keshillit Drejtues te Federates gjate vitit qe kaloi, evidentoi disa nga arritjet, por edhe problemet e mangesite e konstatuara ne punen dhe veprimtarine e Federates e te seksioneve te saj ne rrethe, duke i pare ato te lidhura edhe me veshtiresite qe u krijuan nga fushata e tejzgjatur e zgjedhjeve paramentare dhe ndrrimit te qeverive.

Ai vuri ne dukje, gjithashtu, angazhimin e strukturave drejtuese te Federates per negocimin e

kushteve te kontrates se re kolektive te punes dhe perpjekjet per miratimin e Statusit te Mesuesit.

Pavaresisht se analiza i kushtojte vitit 2005, ajo nuk mund t'u shpetonte problemeve me te cilat po perballlet Federata dhe seksionet e saj ne rrethe gjate muajve te pare te ketij viti. Si ne Fjalen e zotit Dobrushki, ashtu edhe ne diskutimet e anetareve te Keshillit u vleresuan arritjet pas shpalljes se veprimeve sindikale per mritjen e pagave 20 perqind per vitin 2006 dhe u kerkuva qe te insistohet qe mesuesit te marrin edhe pjesen e pages se 13-te per periudhen 1 janar-15 prill 2006, e cila nuk perfshihet ne vendimin perkates te Qeverise. Po keshtu, KD i FSASH, ne menyre unanime theksoi se nuk pajtohet me inisiativat e MASH per diferencimin e pagave te mesuesve te arsimit

parauniversitar sipas lendeve.

Keshilli Drejtues i FSASH vleresoi punen e Kryesise per riorganizimin dhe ndihmesen qe ajo po jep per funksionimin me mire te sindikatave ne arsimin e larte.

Ne vijim, Sekretari i Pergjithshem i Federates, Stavri Liko, paraqiti disa konkluzione mbi bilancin financiar te Federates per vitin 2006, duke u ndalur, si ne gjendjen e problemet qe lidhen me te ardhurat nga kuotat, ashtu edhe per shpenzimet, duke paraqitur edhe projektin per buxhetin e vitit 2006.

Pas diskutimeve ne lidhje me keto probleme, Keshilli miratoi dobjektivat kryesore sindikale te Federates, si dhe buxhetin, perfshire te ardhurat dhe e shpenzimet per vitin 2006.

Keshilli miratoi, gjithashtu, anetaret per Keshillit Drejtues te KSSH, perfaqesues te FSASH-it.

Diskutime konkrete dhe programe pune per te ardhmen

Vijn nga faqja 9

nevoja e mobilizimit te secilit prej anetareve per te mbrojtur dhe realizuar kerkesat social ekonomike.

Ne vijim, lektoret Rolanda Dinci dhe Florinda Ciftja referuan temat mbi mritjen e rolit dhe te pjesemarrjes se grave dhe mesueve te rinj ne sindikate, gje qe u pasua nga puna ne grupe, gjate raportineve te te cileve, theksi u vu tek angazhimi i vete grave per mbrojtjen e interesave te tyre si mesuese e si anetare te sindikates dhe tek motivimi me i mire i mesuesve te rinj per t'i terhequr ata ne sektorin e arsimit dhe ne sindikata. Per te dy keto kategori u percaktuan detyra konkrete edhe per mritjen e perqindjes se perfaqesimit ne te gjitha nivelet e

organeve drejtuese te FSASH e SPASH.

Shume interesante u bene temat e trajtuara nga kryetari i FSASH-it, Zoti Xhafer Dobrushki, i cili u ndale gjeresisht tek roli i sindikatave te arsimit per hartimin dhe zbatimin e strategjise se arsimit ne sektorin parauniversitar, si edhe forcimi i partneritetit social ne nivel lokal dhe roli i organeve kolegiale te FSASH e SPASH per nje bashkepunim efektiv me Drejtorite dhe Zyrat arsimore dhe me drejtorite e shkollave. Per nga vete natyra e saj, kjo teme u konkretizua me shpjegimet dhe diskutimet per veprimet sindikale qe jane duke ndjekur te dyja sindikatat, sidomos per ceshtjet qe kane te bejne me mritjen e

pagave per vitin 2006, diskutimin dhe nenshkrimin e kontrates kolektive te punes, hartimin dhe miratimin e statusit te mesuesit, sistemin e kualifikimeve etj.

Te gjitha pjesemarrjesit ne seminar ish-in aktive e konkrete ne diskutimet e tyre, midis te cileve mund te peme dim sidomos: Pellumb Agolli, Albina Pepo, Bujar Ago, Thona Lice, Nadia Kondili, Aurela Ramizi, Melmet Cane, Zvetllana Polena, Nikolla Ambo, Stoli Xhunga, Nafiz Fifo etj.

Seminari percaktoi detyra te rendesishme per secilin prej seksioneve e pjesemarrjesve per periudhen afatshkurter, deri nga fundi i ketij viti dhe me tej, gjate vitit te ardhshem.

Korresp. i " Tribuna Sindikale"

Sindikatat kanë nevojë për drejtues të zotë

Komunikimi është vlera e parë, zotësia profesionale dhe ndershmëria në marrëdhëniet me njerëzit, gjëja e parë që duhet marrë në konsideratë, kur është fjala për të kërkuar një drejtues sindikate.

Po kujt i bie më mirë mend që, kur bëhen zgjedhjet për organet drejtuese, të tregoheni pak serioz?

Nuk e kemi bërë gjithmonë mirë fushatën e zgjedhjeve, nuk kemi gjetur gjithmonë kandidatët e përshtatshëm për t'ivotuar.

Po pse ka ndodhur kjo?

Se ka munguar njohja. Po jo vetëm kjo. Se kemi dashur të zgjedhim shokët tanë, ata me të cilët ra pëlqen të kalojmë kohën e lirë. Se mendojmë: "Më mirë ky që e njoh, sesa një që nuk e di më kush është."

Dhe kështu ka ndodhur gjithë këto vite.

Konferenca e fundit e KS të Tiranës tregoi se sindikalistët janë të aftë dhe dinë kë të zgjedhin për të drejtuar punët. Nëntë vetat e kryesisë morën detyrat dhe po i realizojnë. Po realizojnë ato detyra që duhej të ishin kapërcyer më herët. Por më mirë vonë se kurrë.

Dhe sa bëhemi mbarë me protagonistët e zgjedhur, do të dalë një gjë që të frikëtoj.

Protagonistia Kozeta Berisha, e përgatitur nga SPASH si lidere e vërtetë sindikaliste, largohet dhe ndërrohet në punë shtetërore. Kështu ka ndodhur gjithmonë. A thua se sindikatat janë trampolinë për të kaluar në punë të tjera?

Po faji mbetet përsëri në sindikatë. Të zgjedhurit duhet të bëjnë një marrëveshje që për një kohë të caktuar nuk mund ta lënë detyrën e sapomarrë.

Tjetër. Në shkolla, si vepron, kush zgjidhet?

Më keq akoma. Nënvlërësohet në maksimum përgatitja e mbledhjeve për zgjedhjet e reja, vihen re mungesa të mëdha. Edhe ata që mbledhen, mendjen e kanë si të kalojë koha për t'u larguar nga mbledhja. Në arsim kjo është e çuditshme. Në momentin e zgjedhjeve nuk shfaqen disa kandidatura njëherësh, nuk zgjidhen në radhë të parë ata që kanë aftësi të komunikojnë, që kanë intonacionin e duhur, pra nuk mendohet për lider...

Të lësh sot pas dore këtë moment do

të thotë të mos mendosh për punë të mirë sindikaliste nesër.

Po kush merret e duhet të merret me këtë njohje e përgatitje?

Në një takim të kryesisë me drejtorin e Arsimit të Rajonit të Tiranës, zonjën Lyda Biçoku, u ra në një mendje që drejtuesit e sindikatës apo sindikatave të dialogojnë me menyre periodike me drejtuesit e shkollave për probleme që preokupojnë mesuesit, sindikatat dhe vete shkollën.

Një bashkëbisedim apo ballafaqim i tillë është thelbi i partneritetit social, është i garantuar nga neni 181 i Kodit të Punës dhe askush nuk mund dhe nuk duhet ta pengojë.

Nuk ka asnjë arsye që, për të mbrojtur pushtetin, për të ruajtur prerimet politike, gjoja për t'u shfaqësuar se nuk menresh me politikë, (!) nuk denjon të presësh në zyrë kryetarët e sindikatave madje, edhe të guxosh të thash: "Dilni nga zyra", me intonacion prepotenti, siç ka ndodhur në gjimnazin Sami Frashëri, ku drejtoresha ka manifestuar një shfaqje të tillë me kryetaren e sindikatës.

Elez Peqoshi, Zv. Kryetari SPA Tiranë

Të hapet dialogu, të lidhen kontratat Kolektive

Të kesh efektivitet në drejtimin e një organizmi sindikal nuk është e lehtë. Por, nuk është edhe aq e vështirë. Gjithëçka mund të realizohet në së miri. Kjo kërkon që të jesh në shërbim të çdo anëtar. Një e nga një bëhet e gjitha. Ky qëllim realizohet i tëri kur sejcili merret pjesë si objekt dhe subjekt i realizimit të këti qëllimi. Duhet studjuar mirë gjëndja e deritanismë. SP e Arsimit e çarkut të Tiranës, përbëhet relativisht nga një numur i madh anëtarësh. A duhet të ishin më shumë? Patjetër që po. Kush ka penguar? Së pari ka penguar Drejtoria e mepareshme Arsimore e çarkut të Tiranës, drejtuesit kryesorë të këtij institucioni të rëndësishëm jo vetëm arsimues por dhe edukues e që përcakton shumë çartë të tasmen dhe të ardhmen e arsimit në këtë çark. Më tej dhe në hapur. SPA e çarkut të Tiranës shihet si "Macja e Zezë" dhe nuk iu firmos kontrata ligjore. U hodh poshtë edhe firma e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës të asaj kohe. Pak kish rëndësi se kush ishin drejtuesit apo aktivistët e kësaj sindikate të cilët ishin

mësues me shumë halle, madje më shumë se të tjerët e që ishin nën presion. Jo dhënies së kushteve në orë mësimi të garantuara me kontratë. Moslejimi i ushtrimit të veprimtarisë në disa shkolla, survejimi se çfarë po thonë e po bëjnë "namin" për mëzimin e pushtetit etj. etj. e që do të thoshte deri në heqjen e asaj nroge të pakët, as sa luka e përditshme. Kohë Migjeniane për këtë sindikatë. Megjithatë, një përvojë u arrit në të gjithë këtë trysni shoqërore, politike, pavarësisht depolitizimit tonë si organizatë.

U ringritën dhe u ngritën sindikata të reja. Ato të mëzuara dhe të frikësuarat lëvizën. Të rejtat mbirën nën shëmbullin e më të vjetrave. Lëvizja sindikaliste e pavarur arsimore, filloi të aktivizohet me kolpot përkatëse e shpesh herë në vartësi të drejtuesve shtetërorë që më shumë ishin njerëz politikë. Me kalimin e kohës u bë e çartë se çfarë përfaqëson kjo sindikatë dhe konkretisht duke lëvizur nëpër shkolla, të pakontraktuar me kontratë, disi të friksuar, u arrit një kuptim më i drejtë nga ana e

mësuesve të Drejtorisë Arsimore të çarkut të Tiranës, se kush jemi ne si sindikatë, çfarë përfaqësojmë dhe çfarë kërkon masa e madhe e intelektualëve arësimitarë. Pikërisht nën këtë trysni shtetërore, numri i anëtarëve dhe sindikata filloi të rritej. Antarësia sindikaliste u bë më e vetëdijshme për mbrojtjen e saj dhe se askush përveç sindikatës nuk mund t'i mbronte më mirë ata dhe të drejtat e tyre. U firmosën listat për grevat njëorëshe, njëditore, pa afat, për protesta, tubime dhe lëvizje të ndryshme. Pati dhe ka jo pak rezultate. A duhet të kënaqemi? Jo. Duhet të përmirësohet më tej dialogu social i bllokuar Drejtoria Arsimore-Sindikata. Qëndrimi i drejtorisë Arsimore në marrëdhëniet me SPA të çarkut të Tiranës duhet të jetë më i përgjegjshëm. Qelësi i përmirësimit të këtyre marrëdhënieve është nënshkrimi i kontratës kolektive. Vetëm një kontratë kolektive heq frikën e mësuesit për pushimin e tij nga puna, heq frikën e mësuesit nga drejtori i komptuar

Vijon në faqen 13

Bashkebisedim me sindikalistet

Në ditët e para të majit prill, Kryetari i FSASH, z. Xhafer Dobrushki zhvilloi takime të vecanta me mesuesit dhe anëtarët e sindikates së Shkolles së Mesme të Bashkuar "Elmaz Ademi" Bardhok dhe Shkolles 9 vjecare "Gani Duraku" Morine, në rrethin e Kukësit, lidhur me mendimet e ketyre sindikalisteve dhe mesuesve për punën dhe veprimtarinë e sindikates qendrore dhe seksionit të rrethit për zgjidhjen e kërkesave dhe shqetsimeve të tyre dhe mbarevajtjen e arsimit në teresi.

Gjeja e parë që të bie në sy është se sindikalistet, mesuesit dhe drejtuesit e ketyre dy shkollave të Komunes Terthore, që shtrihen në rreze të malit të Koritnikut, vetëm pak kilometra larg Kosovës e qytetit të Prizrenit, janë të lidhur fort me profesionin e tyre, me nxënësit e shkollën e tyre. Çdo gjë që shikon brenda ketyre dy shkollave, në zhvillimin e orës së mesimit në klasë, në rregullin e pastertinë, në paraqitjen e mesuesve e nxënësve, në parullat dhe kërkesat që përmbajnë Aktet Normative, në pastertinë e gjuhës dhe në përgjigjet e qytetëzuara të mesuesve, por edhe të nxënësve, të krijojnë menjëherë pershtypjen se gjendesh në një shkollë, ku një kolektiv i tere përploqet e punon për t'i dhënë shkollës së tyre fytyrën e vertetë të një institucioni ose vatre edukimi, sic punohet në qindra e qindra shkolla në qytete ose zra rurale të tjera të vendit, në qendër, në bregdet apo në jug. Vetëm kur del në dorrrin e shkollës e hadh syte nga majat e larta të maleve që ke nubi koke

ose përballë, vetëm atëherë vlerëson me mirë përkushtimin e ketyre dy kolektivave për arsimimin e brezit të ri edhe në skajet më të largëta e zonat më të thella e të vështira të vendit.

Por le të kthehemi tek bisedat, tek mendimet, vërejtjet e sugjerimet e ketyre mesuesve për punën e sindikates apo të sindikatave, që ata ndoshtë e vlerësojnë, shumë gjera nuk i njohin dhe mjaft kërkesa nuk u janë zgjidhur akoma. Ata nuk njohin mirë kontratën kolektive me të cilën

dhe cilesia e dijeve që u transmetojnë nxënësve, kërkojnë me shumë informacion dhe transparencë si nga sindikatat ashtu edhe nga punëdhënësi. Pothuaj çdo gjë që thone është e drejtë. Mbetet që Seksioni Sindikal i rrethit dhe FSASH t'ua plotësojë me mirë, me shpejtë dhe me efektivisht kërkesat modeste të tyre, pa lënë menjëherë ato që janë të përgjithshme si pagat, përmirësimi i sistemit të shpërblimeve e tjerë.

Largohesh nga kolektivat e ketyre



mbrohen, nuk njohin si duhet gjerat elementare të legjislativës së punës, kërkojnë t'ua përmirësohen kushtet e punës, që janë mjaft të vështira, kërkojnë paisje e baze laboratorike që të rritet niveli

shkollave me mendimin se asgjë nuk zëvendëson bisedimin e drejtëpërdrejtë me sindikalistet dhe mesuesit.

Korresp. i " Tribuna Sindikale"

Të hapet dialogu, të lidhen kontratat Kolektive

Vijon nga faqja 12

e prepotent, pra heq frikën e mësuesit nga presioni...Mëgjithë këtë, anëtarët e SPA kanë nevojë për më shumë. Programe lëndore mjaft të ngarkuara e për pasojë ngarkesë e tepërt mësimore për mësuesit...gjë që e mërzhitin tej mase mësuesin sindikalist. Presioni i drejtuesve sindikalistë në arsim ndaj drejtuesve të shkollave duhet të jetë i kualifikuar dhe argumentues, i vazhdueshëm dhe efektiv. Kualifikimi aktual i drejtuesve sindikalistë nëpër shkolla është i dobët. SPASH duhet të angazhojë të gjitha potencialet e saj për kualifikimin e drejtuesve sindikalistë

të sindikatave të vogla në shkolla nëpërmjet të gjitha formave të kualifikimit. Pavarësisht nga pranimet për rritjen e pagave, duhet bërë "zhurmë". Edhe kjo zhurmë, duhet të jetë një zile e fuqishme për të zgjuar nga gjumi në kohë, ata që qëndrojnë ende të fjetur. Arsintarët, duke i rënë kësaj zileje, janë të ndërjegjëshëm se nuk duhet të preket në radhë të parë cilesia e programit të proessit mësimor. Zgjidhje e problemeve të arsintarëve në bashkëpunim dhe jo bllokim e bojkotim jofektiv. Ky është parimi dhe muga jonë e zgjidhjes së problemeve veçanërisht për kualifikimin dhe arsimimin e nëtejshëm të

mësuesve që deri tani ka çaluar dhe vijon të çalojë ende. Problemet janë të shumta.

Të qënit sindikalist dhe anëtar i një sindikate, kërkon përkushtim por edhe korrektesë, veçanërisht në pagesën e kuotës së anëtarësisë. Detyrimet ndaj sindikatës, por dhe përgjegjësitë janë të shumta.

Të bashkuar zgjidhen të gjitha problemet, si ato që përmenden më sipër, ashtu dhe ato që shtohen më pas dhe gjatë punës.

Zhvillimit duhet t'i paraprihet...

Shaban DUKA

Kryetar i SPASH, qarqku Tiranë

Në Shkollën e Mesme "Hoxhë Zogu" në Bytyç, Tropojë

- U mbushën 10 vjet që nuk ka asnjë braktisje të nxënësve në arsimin e detyruar.
- Lidhje e bashkëpunim i ngushtë me shkolla të komunës së Gjakovës.
- Sindikatat e arsimit ndihmojnë procesin mësimor-educativ.

1

Shkolla e mesme e bashkuar e Zogajt, në Komunën e Bytyçit të rrethit Tropojë, mban emrin e atdhetarit e luftëtarit Hoxhë (Sadik) Zogu. Bir i këtij fshati dhe bashkëpunëtor i ngushtë i "Heroit të Popullit" Bajram Curri, ai mbrojti me vendosmëri idealët demokratike të Revolucionit të Qershorit të vitit 19124. Prandaj armiqët e ndoqën këmba-këmbës, deri sa e kapën në befasi dhe e varën në litar, në qendër të Krumës së Hësit, në dimrin e vitit 1925.

janë dy palë xhama dhe klasat e dhomat e tjera janë pajisur me stola e tavolina të reja. Edhe nyjet hidro-sanitare janë ndërtuar funksionale.

Përpjekjet e tërë kolektivit mësues-nxënës tani janë përqendruar në arritjen e objektivit kryesor: "Për mësimdhënie e mësimnxënie cilësore". Në ndihmë të tyre janë dhe kabineti i kimisë e ai i informatikës. Për punë të mirë dhe arritje në procesin mësimor-educativ dallohen maturantët, klasat e 5-të, e 7-të dhe klasa e parë e U, si dhe mësuesit e tyre Ajshe Hajdamataj,

viti.

Gjallërimin të jetës së kolektivit mësues-nxënës i kanë shërbyer shumë edhe lidhjet e bashkëpunimi me shkollat e komunës së qytetit të Gjakovës, që është 7-10 km afër shkollës së fshatit Zogaj. Domethënëse është se 15 ish-maturantë (djem e vajza) i vazhdojnë tani studimet në degë të ndryshme të Shkollës së Lartë Pedagogjike "Bajram Curri" në Gjakovë. Vetë drejtori, prof. Hilmi Hasimja dhe pedagogët i mbajnë ata afër dhe i ndihmojnë që të përparojnë përkrah studentëve kosovarë. Ndërsa në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës, ku është dekan dr. Beqir Sadiku, vazhdojnë 7 studentë nga Zogajt.

Shkolla "Hoxhë Zogu" ka zhvilluar veprimtari të përbashkëta edhe me kolektivin e shkollës 9-vjeçare Xërxë-Rahovec, me shkollën e mesme "Vëllezërit Frashëri" në Deçan, me shkollat e mesme të përgjithshme "Hajdar Dushi" dhe atë mjekësore "Hysni Zajmi" të qytetit të Gjakovës etj. Njohjet e miqësitë e reja, që janë krijuar ndërmjet mësuesve e nxënësve të të dyja palëve, i kanë shërbyer ngritjes së mëtejshme të rendimentit dhe cilësisë në procesin mësimor-educativ.

3

Siç na tregon z. Hajdamataj, në punën mësimore-educative dhe në veprimtaritë e zhvilluara jashtë procesit mësimor, kanë dhënë ndihmesën e tyre të çmuar dhe anëtarët e sindikatave të arsimit të kësaj shkolle të mesme. Kështu, ato kanë bashkëpunuar me drejtorinë për çështje të mësimin, edukimit, mbrojtjes së të drejtave të arsintarëve, për zhvillimin e veprimtarive kulturore e sportive etj. E kanë bërë në të gjallë jetën e kolektivit mësues-nxënës edhe veprimtaritë e zhvilluara me kujdes me raste gëzimesh familjare të mësuesve, për ditëlindjet e nxënësve etj.

Fryt i purës së tyre të përbashkët dhe kënaqësi për tërë mësuesit, nxënësit e prindërit është fakti se u mbushën 10 vjet që në Zogaj nuk ka asnjë braktisje të mësimin të arsimin e detyruar.

Gjatë kësaj periudhe vëndodja e tërë kolektivit është përqendruar në arritjen e rezultateve sa më të larta në procesin mësimor-educativ të nxënësve, në të gjitha lëndët, por sidomos në ato që janë provim.

M urat Gecaj



Për herë të parë, kjo shkollë i çeli dyert në shtator 1937, pas kërkesave këmbëngulëse të malësorëve të etur për dituri e pëparim. Afër 40 nxënësve të atyre anëve u mësoi shkronjat e abetares së shqipëse Mësuesi i Popullit Mustafë Botusha dhe pas tij ish-in mësimdhënës: Rok Dushi nga Shkodra, Ali Musa nga Zogajt, Ismet Hizo nga Vlora e të tjerë. Në vitin 1967 shkolla u bë 7-vjeçare, me 170 nxënës dhe pati drejtorë Pjetër Kukaj, Rukie Ranën, Ibrahim Hamzën etj. Ndërsa në vitin 1987 hapi dyert shkolla e mesme, me 650 nxënës e 37 mësues dhe pati drejtorë Xhemal Hysenukën, Naim Sadikajn, Ibrahim Hajdamatajn etj.

Vitin arsimor 2005-2006 e ndjekin 350 nxënës e ata kanë 22 mësues. Ata i zhvillojnë mësimet dhe veprimtaritë e ndryshme një ndërtesë dykatshe, me kushte mjaft të përshtatshme. Për t'u mbrojtur nga të ftohtit e dimrit, në ditare

Servete Sadikaj, Agim Sadikaj e të tjerë.

Sivjet, prej dyerve të kësaj shkolle të mesme të bashkuar del matyra e 15-të. Ndërsa është viti i 4-t që qind për qind e maturantëve i ndjekin mësimet në shkollat e larta në Tiranë, Shkodër, Elbasan dhe në Gjakovë e Prishtinë. Këtë vit do të hyjnë në provime 20 maturantë. Me punën e bërë nga ata vetë, mësuesit e prindërit, shpresojnë të paraqiten mirë dhe janë regjistruar të gjithë në shkollat e larta, sipas praktikës së re të Maturës Shtetërore.

2

Në shkollën e mesme "Hoxhë Zogu" zhvillohen herë pas here edhe veprimtari kulturore e sportive. Veçanërisht, tregohet kujdes për njohjen e natyrës dhe të historisë së vendlindjes, sidomos përmes ekskursioneve me karakter kalitës e mësimor. Moresa të pashlyera la te pjesëmarrësit edhe ekskursioni i zhvilluar në rrethin fqinj të Hësit, në mars të këtij

Të reja shkencore

MAKINA E PASTER

Biçikleta ENV duket si me muskuj, por në fakt ecën si një biçikletë me motor. E përbërë nga elementë alumini, fare e lehtë, kjo biçikletë ecën me shpejtësi deri në 50 milje në orë, duke përdorur një motor me hidrogjenin si lëndë djegëse. Projektuesi i saj kryesor, Andy Eggleston thotë se kjo



teknologji bën të mundur që të prodhohet më shumë energji se zakonisht. ENV nuk bën zhurmë gjatë ecjes dhe një furnizim prej 4 \$ me hidrogjen mund të përdoret për 100 milje. Disavantazhi i vetëm i saj është se ekziston vetëm një pikë karburanti që tregton hidrogjen dhe ajo është në Kaliforni.

ENV do të jetë e disponueshme për publikun në fillim

të vitit 2007 dhe do të kushtojë rreth 10,000 \$.

NJË LITAR QË E DI


Ashtu siç mund t'ju tregojë çdo zjarrfikës, një litar i thjeshtë mund t'ju shpëtojë jetën, gjithmonë në rast se nuk këputet.

Duke qenë se Litari i Zgjuar është i përbërë nga fibra metalike që përçojnë elektricitetin, ai mund të kuptojë peshën që po mban dhe të lajmërojë përdoruesit për një ngarkesë që është shumë e madhe.

Një marrës dore i transmeton çfarëdo problemi përdoruesit me një mesazh paralajmërimi.

Litari i Zgjuar mund të përdoret edhe në spirancat e anijeve ose në operacionet e shpëtimit.

Për momentin, ai është vetëm një prototip.



NGRI HU DHE NDRI ÇO

E keni pyetur ndonjëherë veten pse ndjeheni si i dehur disa mëngjese dhe disa të tjerë jo?



Arsyeja mund të jetë sepse alarmi juaj u aktivizua kur ju ishit në gjumë të thellë.

Ora që njeh gjumin e zgjidh këtë problem, duke ju zgjuar vetëm kur po bëni një gjumë të lehtë. E pajisur me një sensor të brendshëm lëvizjesh, ora mund të njohë nëse ju po bëni një gjumë të lehtë apo të thellë. (Sa më nervoz të jeni, aq më lehtë flini.) Në mënyrë që të siguroni një orë zgjimi optimale, mbani një rezervë prej rreth 20 min nga ora kur duhet të zgjoheni. Kur të ndjejë se ju jeni gati për të përballuar ditën, alarmi do të fiket automatikisht.

Atë mund ta bleni që tani me një çmim prej 150 \$.

LODRA

SHUMËPËRDORI MSHE

Nëse keni menduar se sistemet e lojrave portative ishin vetëm për fëmijët, Play Station-i Portativ (PSP) do të ndryshojë mëndjen tuaj. Kjo pajisje e lëmuar me ngjyrë të zezë, që ka pothuajse madhësinë e një kutie ku mbahen syzet, ka një ekran të madh të mrekullueshëm. Ai nuk është fantastik vetëm për lojra, por edhe për të parë filma. Rreth 300 filma janë të disponueshëm me formatin Universal Media Disc. Por ka edhe më, PSP (që pranon karta memorie prej 1-GB) mund të



përdoret edhe si album fotosh, si aparat për të dëgjuar muzikë dhe për e-mailin. 250 \$ është çmimi i PSP dhe nga 15 deri në 50 \$ duhet të shpenzoni për lojrat dhe filmat.

Keshilla praktike

Gjashtë këshilla për t'u pasur parasysh gjatë një interviste

Ju është kërkuar të bëni një intervistë pune në një kompani për të cilën keni muaj që interesoheni, por keni vetëm pak ditë për t'u përgatitur për të. Ja ku janë disa këshilla që do t'ju ndihmonin për të bërë një performancë me pesë yje.

1. BËNI KËRKIME NË LIDHJE ME KOMPANINË

Duhet të mësoni sa më shumë që të mundni për punëdhënësin potencial. Në fakt, në një studim të kohëve të fundit të drejtuesve të një kompanie të njohur ndërkombëtare, personat që u përgjigjën se e njihnin pak ose nuk e njihnin fare firmën ishin të parët që u eliminuan nga ana e punonjësit të burimeve njerëzore. Evitoni këto gabim, duke u informuar në lidhje me historinë, produktet dhe shërbimet e kompanisë. Gjeni lajme të kohëve të fundit duke vizituar faqen e saj në internet, duke lexuar publikimet e bëra prej saj dhe duke folur me punonjës të brendshëm. Kjo do t'ju ndihmojë të përqëndrohni veçanërisht në nevojat e kompanisë gjatë intervistës.

2. PRAKTIKA TË PERFEKSIONIT

Ju mund të shmangni një situatë të sikletshme duke marrë parasysh paraprakisht përgjigje ose pyetje të çuditshme gjatë intervistës. Menaxherët e burimeve njerëzore mund të pyesin, për shembull, për dobësinë tuaj më të madhe. Në këtë rast përgjigja juaj duhet të jetë e çiltër por e shkurtër. Në rastin më

ideal, ju duhet të jeni në gjendje të theksoni hapat që keni ndërmarrë për ta pmoshtur këtë të metë. Për shembull, nëse di të flasësh në publik është njëra prej tyre. Ju mund t'i tregoni atij që kryet një kurs për të përmirësuar aftësitë tuaja në lidhje me këtë dobësi.

3. PRISNI TË PAPRITURËN

Kërkimet kanë treguar se pyetjet disi të çuditshme janë bërë të shpeshta, prandaj mos u befasoni nëse ju kërkohet përsëmbull "Nëse do të kishit mundësinë të hanit një drekë me një person të famshëm, kush do të donit të ishte?". Në këtë rast intervistuesit nuk po kërkojnë për një pyetje të saktë apo të gabuar, ata janë më të interesuar të gjykojnë zotësitë tuaja krijuese, aftësinë për të menduar dhe vepruar shpejt dhe personalitetin tuaj. Ktheni përgjigje koncize, por edhe që të përmbajnë informacion për këto tip pyetjesh duke u praktikuar me një shok në mënyrë që të përgjigjeni qartë dhe me siguri në vetvete.

4. KUSHTOJINI VËMËNDJE DETAJEVE

Korrektesia, veshja e përshtatshme dhe prezenca e këndshme kontribuojnë të gjitha për reputacionin profesional të kujt do. Prandaj ju duhet t'i kushtoni vëmëndje aspekteve të vogla dhe shpesh të fshehura të një interviste. Zgjidhni veshjen që do të përdornit një natë më parë. Një kostum serioz do të ishte i përshtatshëm në çdo rast dhe sigurohuni që të jetë i pastër dhe i hekurosuar me kujdes. Mendoni për rrugën

deri në zyrë, planifikoni të niseni shpejt dhe personin që do të telefononi në rast se bllokoheni në trafik. Më në fund, bëni një gjumë të qetë që të jeni gati për ditën e madhe.

5. TREGONI DIÇKA PERSONALE

Ju mund ta përdorni të shkuarën në avantazhin tuaj. Kini parasysh tre arritje profesionale në karrierën tuaj që tregojnë cilësitë tuaja, si për shembull iniciativa, puna në grup, aftësitë drejtuese, të cilat nuk janë vënë në dukje në kurikulumin tuaj. Ndoshta keni qëndruar në zyrë deri në orët e vona të natës për të ndihmuar një koleg në realizimin në kohë të një projekti. Ndonëse nuk ishte përgjegjësia juaj, ju patë një koleg në vështirësi dhe ishit të lumtur ta ndihmoni.

6. RRËMONI THELLË

Është shumë e vlefshme të konsultoni intervistuesin tuaj në lidhje me pyetjet që mund të keni në lidhje me firmën ose rolin tuaj. Në fakt, bëra e një sërë pyetjesh nga ana juaj është një mënyrë shumë e mirë për të rritur më tej interesin tuaj në punë. Kërkoni informacion për mundësitë për t'u rritur në detyrë si edhe planet afatgjatë të kompanisë. Diskutimi i këtyre çështjeve do t'ju ndihmonte të përcaktonit nëse do të ishit i përshtatshëm për pozicionin në fjalë. Vetëm evitoni të pyesni në lidhje me pushimet, përfitimet e pagesën.

Përgatiti faqen *Erica Vangjeli*

Tribuna sindikale

